



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
PROKURORIA E PERGJITHSHME  
DREJTORIA E KRIMIT TE ORGANIZUAR

Nr. 695/ Prot.  
4

Tirane, me 10.5..2002

**LEND A : Mbi regjistrimin e procedimeve penale.**

**PROKURORISE PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**

Duke mare shkas nga praktikat e deritanishme mbi trajtimin e materialeve kallezuese me objekt veprat penale ne fushen e financave dhe te ekonomise te bera keto nga organe te specializuara sic jane Kontrolli i Larte i Shtetit apo institucione te tjera, me qellim unifikimi te praktikes si dhe zgjidhjes ligjore te tyre,orientojme sa vijon:

Ne veshtrim te nenit 281 te Kodit te Procedures Penale behet e qarte detyrimi qe duhet te permbushin keto institucione para dergimit te kallezimit ne prokurori.Sipas pikes 4 te nenit te sipercituar,kallezimi duhet te permbaje elementet thelbesore te faktit,burimet e proves,gjeneralitetet,banimin dhe cdo gje tjeter qe vlen per identifikimin e personit te cilit i atribuohet fakti,te personit

te demtuar dhe te atyre qe jane ne gjendje te sqarojne rrethanat e faktit.

Bazuar sa siper te tregohet vemendja e duhur ne studimin e materialeve kallezuese para se ato te regjistrohen dhe ne se konstatohet se nuk jane permbushur detyrimet ligjore nga ana e kallezuesit dhe nuk mund te sqarohet nepermjet verifikimit, materiali te kthehet per plotesim dhe me detyra konkrete.

Ne praktiken e deritanishme verejme se kallezime te kesaj natyre menjehere sa mbrijne ne organ, regjistrohen ne regjistrin e procedimeve duke lejuar zvarritje te pa justifikuara dhe zgjatje te afatit te hetimeve per veprime qe ne fakt duhet te ishin kryer nga vete kallezuesi para dergimit te materialit ne organin e prokurorise. Per me teper, mbajtja per nje periudhe kohe te gjate ne hetim e kallezimeve te kesaj natyre eshte me pasoja te demshme duke lene shteg per keqinterpretime.

Njoftimi i organit qe ka bere kallezimin mbi menyren e perfundimit te tij eshte nje detyrim ligjor i prokurorit, ne veshtrim te neneve 291 e 329 te K.Pr.Penale, ne te kundert, padrejtesisht menjanohet nga e drejta e ankimit te nje vendimi organi kallezues, i demtuari apo personi i marre si i pandehur.

Materiali te punohet ne takim me prokuroret dhe oficeret e policise gjyqesore me qellim qe shkelje te kesaj natyre te evitohen ne te ardhmen.

**PROKURORI I PERGJITHSHEM**

**THEODHORI SOLLAKU**

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Theodhori Sollaku', written in a cursive style below the printed name.